

VENDIM
Nr. 164, datë 1.3.2017

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 44.7 HA NË OBJEKTIN “BLINISHT”, TË QARKUT TË LEZHËS, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “BALKAN BASALT” SHPK PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË BAZALTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore dhe kullimore publike prej 44.7 ha, që shtrihet në ngastrat 12a, 13b, 50a, 51a, 51b, 52a, 52b në objektin “Blinisht”, të ekonomisë pyjore “Spaç”, në qarkun e Lezhës, e cila përdoret nga shoqëria “Balkan Basalt” sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit të bazaltit, të hiqet nga fondi pyjor e kullor publik, të pakësohet në volum dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqen pyjore, dhe harta topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt minerar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor dhe të produkteve të tjera pyjore e kullimore, në sipërfaqen objekt minerar, paguhet nga shoqëria “Balkan Basalt” sh.p.k., në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Balkan Basalt” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet në përdorim sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda tre viteve të para, të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe pyjore prej 35.95 ha në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit.

4. Sipërfaqet pyjore dhe kullimore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore dhe kullimore të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, nga shoqëria “Balkan Basalt” sh.p.k., sipërfaqja pyjore e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Mirditë dhe shoqëria “Balkan Basalt” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT MINERAR NGA SHOQËRIA “BALKAN BASALT” sh.p.k. në qarkun e LEZHËS


QARKU LEZHË

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullosore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Përdorimi territorit</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)</i>
LE 38 00	SPAÇ	12a	shkurre	babshkia Mirdite	0.352
LE 38 00	SPAÇ	13b	shkurre	babshkia Mirdite	0.184
LE 38 00	SPAÇ	50a	shkurre	babshkia Mirdite	1.144
LE 38 00	SPAÇ	51a	shkurre	babshkia Mirdite	21.42
LE 38 00	SPAÇ	51b	shkembore	babshkia Mirdite	5.573
LE 38 00	SPAÇ	52a	shkurre	babshkia Mirdite	12.88
LE 38 00	SPAÇ	52b	shkembore	babshkia Mirdite	3.179
GJITHSEJ					44.7

HARTA KADASTRALE

SH. 1:25 000



KUFIRI I LEJES MINERARE

KOORDINATA KUFIZUESE		
PIKA	X	Y
1	46 39 339	44 20 157
2	46 39 291	44 20 503
3	46 37 934	44 20 174
4	46 38 347	44 19 835
Sipërfaqja = 0.447 Km ²		

SIPERFAQJE PARCELA	
NR. PARCELE	SIPERFAQJA M2
50-a	11 437
51-b	55 728
51-a	214 156
12-a	3 520
13-b	1 837
52-a	128 822
52-b	31 796
Sipërfaqja = 0.447 Km ² (447 296 m2)	

PROJEKTUES:	TIRANE
"STUDIO PROJEKT" SH.P.K	2015
OBJEKTI:	
STUDIMI TEKNIKO-EKONOMIK DHE PROJEKTI I SHFRYTEZIMIT TE	
VENDBURIMIT TE BAZALTEVE, BLINISHT	
QARKU LEZHE	
POROSITES:	
"BALKAN BASALT" shpk	
EMERTIMI I FLETES:	
HARTA KADASTRALE	
GRUPI PROJEKTIMIT :	Nr. Lic.
INGJINIER MINIERE	YMERVAIR DERMATSH
INGJINIER GJEOLOG	
TOPOGRAF:	
GJEOINGJINIER:	ERMIR DERMATSH
Data:	Emri i fletes:
1/2015	0-01

